




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.:	Nr. Prot.:
Dep. 2-D/	Br. Prot. 01-419/16
Dep.:	Prot. No.:
Nr. titull:	Data:
Broj shifra: 02	Datum 02-02-2016
Nr. pages:	Date:
	02
	02-02-2016
	PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.02.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-3953-15, për Zyrтарin e lartë, z. Burim Gërguri – Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës në Komunën e Obiliqit, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-3953-15, për Zyrтарin e lartë, z. Burim Gërguri – Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës – Komuna e Obiliqit, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. Gërguri është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Gërguri është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Mirëpo, megjithatë z. Gërguri këtë nuk e ka bërë brenda afatit të parashikuar ligjor, Agjencioni kundër Korrupsionit ka bërë edhe shkresën e dytë (Paralajmëruese) në të cilën AKK ka konstatuar konfliktin e interesit dhe i ka dhënë afatin ligjor për ndryshime bashkë me njoftimin se pas këtij afati lënda shkon në Gjykatën kompetente.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell informatat mbi bizneset (DPK/DPKI-03-02-383/16 dhe Dpk-Dpki-03-02-384/16), nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në

Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se te biznesi D.P.H.“Viski Bar” dhe D.H.”Viski” Kiosk, z.Gërguri tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, duke emëruar në këto pozita një person të besuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Hasan Preteni /